



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3138/5 prot.

Datë 09.12.2025

V E N D I M

Nr.1823/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.12.2025 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “START CO” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-63982-10- 07-2025, me objekt: “Blerje Fadrome”, me fond limit 7,670,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 20-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Devoll, me adresë: Lagjia nr.1, Rruga 24 Tetori nr.5.

Ankimues: Operatori ekonomik “START CO” SHPK me NIPT (L11614001S), me adresë: Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla G&P, Kati 1.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.10.2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-63982-10-07-2025, me objekt: “Blerje Fadrome”, me fond limit 7,670,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 20-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.

II.2. Në datën 08-10-2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më

datë 29.10.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---|------------------------|
| 1. “ARTEO 2018” SHPK | 6,450,000 Skualifikuar |
| 2. “START CO” SHPK | 7,499,900 Skualifikuar |
| <i>(Operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.3.3 : ”Mjeti te jete i zhdoganuar dhe OE duhet te parqesin dokumentin e zhdoganimit” OE nuk ka paraqitur deklaraten e zhdoganimit per mjetin objekt prokurimi.)</i> | |
| 3. “UNITRACK ALBANI” SHA | 7,600,000 Skualifikuar |
| 4. “VILDEV – CO” SHPK | 7,640,000 Kualifikuar |

II.4 Në datën 30.10.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 03.11.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/6043, datë 03.11.2025 dhe me nr. protokolli 3138/2025 datë 04.11.2025 e operatorit ekonomik “START CO” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-63982-10-07-2025, me objekt: “Blerje Fadrome”, me fond limit 7,670,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 20-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3138/1 prot, datë 04.11.2025, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “START CO” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.7. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit, ka përcjellë me shkresën nr. 3793 prot., datë 12.11.2025, protokolluar me tonën me nr.3138/2 prot., datë 17.11.2025, vendimin e KSHA mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “START CO” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “START CO” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre me arsyen se : “...Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

*Pra, operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. «ertifikata e mjetit është një dokument i cili ka të dhëna teknike rreth mjetit e cila shërben dhe paraqitet pranë ambjenteve të DPSHTRR, për rregjistrimin dhe targimin e mjetit. MË pas me anë të kësaj aertifikatës poseduesi i mjetit përfiton librezën e mjetit. Nëse në pikën 2.3.2 Autoriteti kontraktues lejon dhe pranon që Operatori Ekonomik mund të paraqesë certifikatën e mjetit, rrjedhimisht bie në kundërshtim me kërkesën 2.3.3 që specifikisht kërkohet që Mjeti të jetë i zhdoganuar dhe OE duhet të paraqesi dokumentin e zhdoganimit. Deklarata doganore është një dokument që ka shumë pak të dhëna teknike që nuk i shërben aspak AK për të vërtetuar plotësimin e specifikimeve teknike të mjetit dhe për më tepër ky dokument është një dokument konfidencial në të cilin ka të dhënat e shumës se blerjes dhe detaje të tjera që jo detyrimisht që OE duhet ti ndaj me shitesin final. Për më tepër që kjo kërkesë penalizon shumë OE të cilët plotësojnë specifikimet teknike të mjetit dhe cilët janë të gatshëm ta sjellin mjetin në afatin e përcaktuar nga AK. Përcaktimi i këtij kriteri vendos në pozita të pabarabarta operatorët ekonomik pjesëmarrës ku ofertues i suksesëshëm do të quhen vetëm operatorët ekonomik të cilën e kanë kryer zhdoganimin e mjetit dhe jo OE që kanë këtë mjet gjendje në fabrik theksojmë mjetin në përputhje të plotë me specifikimet teknike por që jo detyrimisht kanë kryer zhdoganimin e tij. Akoma me tej, Autoriteti kontraktor ka përcaktuar në DST se Afatet e lëvrimit janë 1 (nje) muaj duke filluar nga nënshkrimi i kontrates. Shoqeria jonë Start CO shpk, jo vetëm ka plotësuar kriteret mbi specifikimet teknike por kemi dorëzuar në SPE, shtojcës 8, dhe kemi plotësuar deklaratën, Pjesa III Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit A: DEKLARATË NË përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës, ku marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor. **Duke qenë se AK specifikon në kërkesën se një OE mund të paraqesë certifikatën ose librezën e mjetit si dhe foto te mjetit rrjedhimisht duhet të pranohet dhe oferta ekonomikë e një mjeti pa deklaratë doganore por që plotëson specifikimet teknike të këtij mjeti me ato të përcaktuara në DST.** Sa më sipër, ky kriter i autoritetit kontraktor, kanë vendosur në pozita jo të barabarta operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. Për më tepër, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në mënyrë konkrete dokumentacionin që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë ofertues dhe të mos krijojë konfuzion dhe pabarazi ndërmjet operatorëve ekonomikë të cilët shprehin interesin e tyre për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi. Vendosja e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë, në kushte jo të barabarta, e bën të pamundur një vlerësim objektiv të ofertave të paraqitura nga ofertuesit. Gjithashtu nuk duhet të harrojmë qëllimin e ligjit të prokurimit publik, si në drejtim të sigurimit të trajtimit të*

barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë por edhe atë të mirëpërdorimit të fondeve publike dhe shpenzimeve procedurale.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 6 “*Formulari I Specifikimeve Teknike*”, e procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:”

“FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikime teknike per Fadromën me goma janë si më poshtë vijon:

1-Viti i Prodhimit 2025

2- Fuqia Motorike: jo më pak 50 kË ose 70 HP

3-Lenda djegese: Naftë (Diezel)

4- Me kamio 6-she me teknologji te dyfishte sinkronizuese

5- Shpejtësi maksimale të paktën 41.8 km/ore

6- Te jete 4x4

7- Te jete full option

8- Kilometrat 0 km ose 0 ore pune

9- Kabina të jetë e certifikuar me sisitem ngrohje-ftohje.

10- Kova e ngarkimit të jetë shumëfunktionale me krah teleskopik, bige me zgjatje, dalje cekici.

11- Mjeti te jete i zhdoganuar ”

III.1.2. Ndërsa në dokumentet e tenderit, shtojca 8 “*Formular i Kritereve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit*”, e procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:”

“2.3.3. Mjeti te jete i zhdoganuar dhe OE duhet te parqesin dokumentin e zhdoganimit.”

III.1.3. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket kritereve të vecanta pikës 2.3 dhe specifikimeve teknike, operatori ekonomik “STAR CO” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:



13_START_CO_SHPK_ISO.pdf



5_Shtojca_9_Formulari_permbledhes_i_vetedeklarimit.pdf



Katalog_fadrom_102B_Alpha.pdf



14_Deklarate_transporti.pdf



COC_e_mjetit_fadrom_102B_Alpha.pdf



FSHZH_Nderhyrje_per_permiresimin_e_konektivitetit_dhe_rrugeve_te_ankesit_ne_zona (1).pdf



11_Start_Co-FSHZH_Minikontrate.pdf

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.1.5. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.6. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...] 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet*

nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.1.7. Në Nenin 92 pika 3 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

III.1.8. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave. 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. 3. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.1.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe

ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuesë dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuesë dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt prokurim.

III.1.10. Në këtë rast, referuar dhe sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar në pikën 2.3.3 kapaciteti teknik, dokumentet që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Star CO” SHPK në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, pika 2.3.3 kapaciteti teknik dhe të specifikimeve teknike KPP konstaton, se ky i fundit, nuk ka dorëzuar dokumentin e zhdoganimit por dokumentacionin me titullin “ISO”, “Formulari_permbledhes_i_vetedeklarimit”, “COC_e_mjetit_fadrom_102B_Alpha”(deklaratë e konformitetit e BE-së e Hidromek), “Katalog_fadrom_102B_Alpha” dhe “Deklarate_transporti”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues, si pjesë të ofertës së tij, nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në dokumentet standarde të tenderit për kriterin e mësipërm për dokumentin e zhdoganimit pasi prej përmbajtjeve të dokumentave të dorëzuara në SPE nga operatori ekonomik “Star CO” SHPK konstatohet letësisht mos plotësimi i kriterit 2.3.3 sikurse kërkuar nga autortiteti kontraktor. Konkretisht është kërkuar që mjeti të jetë i zhdoganuar dhe OE duhet të paraqesin dokumentin e zhdoganimit. Nga ana tjetër operatori ekonomik ankimues më anë të ankesës A/2025/6043, datë 03.11.2025 dhe me nr. protokolli 3138/2025 datë 04.11.2025 në arsyetimin e tij ka argumentuar se “Duke qenë se AK specifikon në kërkesën se një OE mund të paraqesë certifikatën ose librezën e mjetit si dhe foto të mjetit rrjedhimisht **duhet të pranohet dhe oferta ekonomikë e një mjeti pa deklaratë doganore** por që plotëson specifikimet teknike të këtij mjeti me ato të përcaktuara në DST”, duke pohuar mungesën e këtij dokumentacioni. Komisioni sjell në vëmendje se u janë dhënë të gjitha garancitë të gjithë operatorëve ekonomik të

cilët pretendojnë për shkelje në procedura prokurimi publik të paraqiten me ankesë për dokumentet e tenderit sipas afateve të parashikuara në nenin 110 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit, pasi me kalimin e kësaj faze me të drejtë autortiteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit dhe janë operatorët ekonomik pjesëmarrës që me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Nga sa parashtuar dhe më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues “Star CO” SHPK nuk ka plotësuar kriterin teknik 2.3.3 të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Star CO” SHPK, në procedurën e prokurimit, “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-63982-10- 07-2025, me objekt: “Blerje Fadrome”, me fond limit 7,670,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 20-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.
2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kalimin në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Star Co” Shpk.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

